



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA KOMERCIALE

Numri i lëndës: 2023:264937
Datë: 28.06.2024
Numri i dokumentit: 05876247

KPPP.nr.2060/23

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, Gjyqtari Alajdin Tërshnjaku, në çështjen përmbare të kreditorit Kompania Regjionale e Mbeturinave "Uniteti" SH.A., me adresë rr. V.Dragaj pn, në Mitrovicë, me NRB: 70465104, kundër debitorit N.P.Z Te Luli, L.H. B.I., me adresë rr. Hamit Hyseni, në Vushtrri, me NRB: 810689242, duke vendosur lidhur me prapësimin e debitorit të ushtruar kundër Urdhrit Përmbare P.nr.1518/23 të datës 25.10.2023, të Përmbaresit Privat Atip Mustafa me seli në Mitrovicë, jashtë seancës, me datë 20.06.2024, merr këtë:

A K T V E N D I M

- I. PRANOHET si i bazuar prapësimi i debitorit N.P.Z Te Luli, L.H. B.I., dhe ANULOHET Urdhri përmbare P.nr.1518/23 i datës 25.10.2023, i Përmbaresit Privat Atip Mustafa dhe PËRFUNDOHET në tërësi përmbaremi në këtë çështje përmbare.

A r s y e t i m

Përmbaresi Privat, duke vepruar sipas propozimit të kreditorit Kompania Regjionale e Mbeturinave "Uniteti" SH.A., ka caktuar urdhrin përmbare P.nr.1518/23 të datës 25.10.2023, me të cilin ka lejuar përmbaremin në bazë të dokumentit të besueshëm - Ekstrakti i verifikuar nga librat afarist VU.5.B.40.191194 të datës 26.09.2023, të lëshuar nga kreditori, me të cilin është detyruar debitori që në emër të përmbushjes së obligimeve nga dokumenti i besueshëm i lartcekur, brenda afatit prej 7 ditësh nga data e dorëzimit të urdhrin, t'ia paguajë kreditorit shumën

prej 459.50 Euro, me kamatë ligjore prej 8% duke e llogaritur nga data e paraqitjes së propozimit e deri te pagesa definitive, si dhe të gjitha shpenzimet e procedurës përmbarimore, që do të krijohen prej momentit të dorëzimit të këtij propozimi, dhe të gjitha këto detyrime të realizohen përmes zbatimit të përmbarimit sipas llogarive bankare të debitorit dhe bartjen e tyre në llogarinë bankare të kreditorit, dhe nëse debitori nuk posedon mjete monetare në llogarinë e tij bankare, përmbarimi të zbatohet përmes sekuestrimit të sendeve të luajtshme dhe të paluajtshme të debitorit dhe me shitjen e tyre të bëhet inkasimi i borxhit në llogari të kreditorit.

Debitori në prapësimin e paraqitur brenda afatit ligjor, ka kundërshtuar urdhrin përmbarimor, me arsyetimin se kreditori kërkon pagesën nga debitori ndërsa nuk i ofron asnjë shërbim të njejtit. Më tutje ka theksuar se kreditori në propozimin për përmbarim fare nuk cek periudhën se prej kur deri kur kërkon borxhin, por vetëm i ka bashkangjitur propozimit ekstrakte nga libri afarist për vitet 2018,2019,2020,2021,2022 deri në tetor 2023, që si i tillë propozimi nuk është i përpiluar konform dispozitave të LPP-së. I ka propozuar gjykatës që prapësimi i debitorit të aprovohet si i bazuar, të anulohet urdhri përmbarimor, si dhe të prishen veprimet e ndërmarura për shkak se ky borxh është vjetërsuar.

Kreditori në përgjigjen në prapësim të paraqitur brenda afatit ligjor, ka theksuar se në rastin konkret procedura përmbarimore është bazuar në faturat apo ekstraktet e paraqitura nga ana e kreditorit të cilat i përmbajnë të gjitha të dhënat e nevojshme duke u bazuar në nenin 40 të LPP-së. Më tutje ka theksuar se neni 368 i LMD-së e përcakton qartë procedurën e ndërprerjes së afatit të parashkrimit, kur debitori pranon borxhin edhe në mënyrë të tërthortë, ngase në kartelat financiare në shkresat e lëndës shihet qartë se kemi pranim të borxhit nga debitori, ku i njejtë ka kryer pagesa kohë pas kohe në emër të këtij borxhi. I ka propozuar gjykatës që prapësimi i debitorit të refuzohet në tërësi i pabazuar ndërsa të mbetet në fuqi urdhri i Përmbaruesit Privat.

Gjykata pas shqyrtimit të pretendimeve të debitorit të paraqitura në prapësim, përgjigjes në prapësim të kreditorit si dhe vlerësimit të provave që gjenden në shkresat e lëndës, duke iu referuar dispozitave të nenit 69 dhe 71 të Ligjit Nr. 04/L-139 për Procedurën Përmbarimore (tutje LPP) dhe nenit 12 par. 2 të Ligjit Nr. 05/L-118 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr. 04/L-139 Për Procedurën Përmbarimore, gjeti se prapësimi i debitorit është i bazuar dhe se urdhri përmbarimor duhet të anulohet dhe procedura përmbarimore të përfundojë në tërësi, për shkaqet si në vijim:

Gjykata vlerëson se në rastin konkret dokumenti i besueshëm - Ekstrakti i verifikuar nga librat afarist nr. nr.MI.3.B.68.391449, në bazë të së cilës është lejuar urdhri për përmbardim, nuk i plotëson kushtet e parapara me nenin 29 dhe nenin 37 të LPP-së.

Sipas nenit 29 par.1 të LPP-së, përcaktohet se “Përmbardimi me qëllim të realizimit të kërkesës në të holla caktohet edhe në bazë të dokumentit të besueshëm”, ndërsa në par.2 të po këtij neni, si dokument i besueshëm sipas ligjit konsiderohen *“ekstraktet e verifikuara nga librat afariste për pagesat e shërbimeve komunale të furnizimit me ujë, energji elektrike dhe bartjen e mbeturinave”*, ndërsa me nenin 29 par. 3 të LPP-së, përcaktohet se *“Dokumenti i besueshëm është i përshtatshëm për përmbardim po qe se në të është treguar kreditori dhe debitori, si dhe objekti, lloji, shuma dhe koha e përmbushjes së detyrimit monetar”*, kurse me nenin 37 të LPP-së, përcaktohet se *“Kur propozimi për përmbardim paraqitet në bazë të dokumentit të besueshëm, mjafton që propozimit t’i bashkëngjitet dokumenti i tillë original apo kopja e tij e vërtetuar sipas ligjit.”*.

Gjykata duke u bazuar në të lartcekurat gjeti se Ekstrakti i verifikuar nga librat afarist VU.5.B.40.191194 i datës 26.09.2023, në bazë të së cilës është lejuar propozimi për përmbardim nuk i plotëson kushtet ligjore për të qenë dokument i besueshëm, për faktin se një dokument i tillë, nuk i plotëson kushtet e përcaktuara për të qenë dokument i besueshëm sipas nenit 29 paragrafi 1 nën paragrafi 1.2 të LPP-së.

Bazuar në dispozitën e lartcekur, është përcaktuar se në kuadër të dokumenteve të besueshme janë ekstraktet e verifikuara nga librat afarist sa i përket pagesave të shërbimeve komunale për furnizim me ujë, energji elektrike dhe bartje të mbeturinave.

Në rastin konkret pavarësisht faktit se propozimi për përmbardim është lejuar sipas një dokumenti - nga librat afarist në kuadër të Ndërmarrjes KRM “Uniteti” SH.A, gjykata gjeti se Ekstrakti i verifikuar nga librat afarist VU.5.B.40.191194 i datës 26.09.2023, mbi të cilin mbështetet propozimi për përmbardim, e mbi bazën e të cilit Përmbarduesi Privat ka lejuar përmbardimin, nuk i plotëson kushtet që të konsiderohet dokument i besueshëm, meqenëse në këtë dokument nuk është përcaktuar saktë objekti i detyrimit dhe nuk mund të konstatohet se për cilat periudha kohore është krijuar dhe është kërkuar përmbushja e borxhit nga debitori.

Duke u bazuar në të lartcekurat, gjykata gjeti se borxhet të cilat janë akumuluar nga vitet: 2018, 2019, 2020 dhe 2021 dhe 2022 janë bartur në vitin pasues, me përshkrimin “*carried over from the*”, duke e faturuar të njëjtin si borxh të ri.

Andaj, gjykata vlerëson se dokumenti në bazë të së cilit është lejuar urdhri përmbarimor në rastin konkret, nuk i ka tiparet e ekstraktit të verifikuar nga librat afariste dhe nuk ka tipare të përmbarueshmërisë, si rrjedhojë nuk i shqyrtoi fare pretendimet tjera të debitorit të paraqitura në prapësim, si dhe të kreditorit të paraqitura në përgjigjen në prapësim dhe duke u bazuar në nenin 71 dhe 73 të LPP-së, nenin 12 par. 2 të Ligjit Nr.05/L-118 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr. 04/L-139 për Procedurën Përmbarimore, si dhe nenin 13 par.1 nën par 1.2 të Ligjit nr. 08/L-015 për Gjykatën Komerciale, vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Dhomat e Shkallës së Parë - Departamenti për Çështje Ekonomike

KPPP.nr.2060/23 më datë 20.06.2024

Gjyqtari

Alajdin Tërshnjaku

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi palët kanë të drejtë ankese në afat prej shtatë (7) ditëve, nga dita e pranimit të aktvendimit, në Dhomat e Shkallës së Dytë, në Gjykatën Komerciale të Kosovës, përmes Dhomave të Shkallës së parë të kësaj Gjykat

Numri i lëndës: 2023:264937
Datë: 28.06.2024
Numri i dokumentit: 05876247